

STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Albanian Fiber Telecommunications” SHPK
ME ORTAK TË VETËM

KAPITULLI I
Emërtimi, Forma Ligjore, Selia, Kohëzgjatja

Sot, më 05.10.2021, në Tiranë, Ortaku Themelues (më poshtë quajtur si “**Ortaku**”) nënshkruan këtë Statut, me përmbajtje si vijon:

Neni 1. Emërtimi i Shoqërisë

1.1 Emërtimi i Shoqërisë (“**Shoqëria**”) është “**Albanian Fiber Telecommunications**” **sh.p.k.** Në të gjitha dokumentet, faturat, reklammat dhe publikimet e nxjerra nga Shoqëria, emri do të pasohet nga:

a. Fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ;

b. Selia.

Neni 2. Forma Ligjore e Shoqërisë

2.1. Shoqëria Tregtare “**Albanian Fiber Telecommunications**” **shpk** është person juridik shqiptar, i organizuar ligjërisht si një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjet e Shqipërisë, dhe dispozitat e statutit aktual apo atyre që do vijojnë.

Neni 3. Selia e Shoqërisë

3.1. Selia e Shoqërisë është në adresën :

Rruga "Ibrahim Rugova", Nderresa Nr. 42, Hyrja Nr.7, Kati 2, Njesia Bashkiake Nr.5, Kodi Postar 1019, Tiranë.

3.2 Shoqëria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund të kryejë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, nëpërmjet filialeve, degëve, zyrave të përfaqësimit ose agjensitë e saj, të cilat janë krijuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Neni 4. Kohëzgjatja e Shoqërisë

4.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pa përcaktuar.



KAPITULLI II
Objekti i Shoqërisë

Neni 5. Objekti i Shoqërisë

5.1. Objekti i aktiviteteve të Shoqërisë është si më poshtë:

- Te ideoje zbatoje dhe te menaxhoje rrjete te telekomunikacionit dhe transmetimit te te dhenave si edhe interkoneksionet ne pergjithesi.
- Te plotesoje nevojat industriale, tregtare, sociale dhe te rezidenteve per sherbime telekomunikacioni gjithperfshirese dhe efektive. Te kenaqe te gjitha kerkesat praktike dhe te arsyeshme per keto sherbime.
- Te siguroje sherbime konsulence, keshillimi, trajnimi dhe kontrata sherbimi.
- Te interkonjektohet me ofrues te tjere sherbimesh dhe shoqeri te telekomunikacionit per te furnizuar sherbime end-to-end.
- Te ofroje sherbime audio dhe/ose audiovizive.

Per arritjen e qellimeve me siper, shoqeria gjithashtu mund:

- Te kryeje cdo transakcion lidhur me pasurite e luajtshme dhe me pasuri te paluajtshme si edhe cdo aktivitete tregtare finaciar dhenien me qera ose lenie peng i cili mund te konsiderohet si i dobishem dhe i nevojshem.
- Te bleje direk ose indirekt interesa ne shoqeri te tjera te cilat kane nje qellim te njejte me ate te shoqerise ne Shqiperi ose jashte saj.
- Te kryeje cdo gje qe shoqerise i duket e nevojshme e leverdishme ose e rastesishme per te arritur qellimin e saj.

Gjithashtu shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm

- 5.2 Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj;
- 5.3 Shoqëria, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.
- 5.4 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakësohet në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.
- 5.5 Shoqëria duhet të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse. Ajo përfshin standartet më të mira etike.



Neni 6. Ndryshimet

- 6.1. Shoqëria rezervon të drejtën për të ndryshuar objektin në çdo kohë, ashtu sic përcaktohet në statut, sipas vendimeve të marra nga asambleja e përgjithshme.

KAPITULLI III
Kapitali themeltar

Neni 7. Kapitali themeltar dhe Ortakët e shoqërisë

- 7.1. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontribut në para dhe është I barabartë me vlerën 100.000 lekë (njëqind mije) dhe që përfaqëson 1 kuotë.
Kapitali themeltar I takon ortakut të shoqërisë.
- 7.2. Përgjegjësia e ortakut për mbulimin personalisht të humbjeve të Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.
- 7.3. Kuotat janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo kohë në përputhje me kushtet dhe afatet që përcaktohen në ligjin shqiptar.
- 7.4. **Z. Altin Ceni** i biri i Ramazanit dhe i Iritit, shtetas shqiptar lindur më Burrel, në datën 23.10.1972, dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi shqiptar, Pasaporte nr. BB3404306, numër personal H21023121F zotërues i 1 (një) kuote të barabartë me 100.000 Lekë, dhe që përfaqëson 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë.

Neni 8. Zvogëlimi dhe Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

- 8.1 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të asamblesë, në çdo kohë dhe më shumë se një herë, përmes kontributeve “në para” apo “në natyrë”, në zbatim të ligjeve në fuqi, në momentin e zmadhimit ose zvogëlimit të kapitalit dhe të këtij statuti. Vendimet e asamblesë lidhur me zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë duhet të merren sipas ligjeve në fuqi.
- 8.2 Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të asamblesë, në zbatim të ligjeve në fuqi dhe të statutit. Në çdo rast, kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet përtej minimumit të parashikuar me ligj.

Neni 9. Zoterimi i Kuotave

- 9.1. Kuotat janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.



9.2 Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit. Shoqëria regjistron kalimin e kuotës në QKB.

Neni 10. Të drejtat dhe detyrimet e ortakëve

- 10.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
- 10.2 Ortaket kanë të drejtë të marrin pjesë në menaxhimin e Shoqërisë dhe në shpërndarjen e fitimeve, të njoftohen për veprimtarinë e Shoqërisë, të shqyrtojnë Librin e Vendimeve të Shoqërisë, dhe kanë të drejtë të marrin pjesën që ju takon pas likuidimit të Shoqërisë ose pasurisë së falimentuar.
- 10.3 Kuotat e Shoqërisë janë lirish të transferueshme dhe të trashëgueshme, Ortaket mund të lenë peng kuotat e tyre.
- 10.4 Ortaket mund të transferojnë kuotat e tyre tek personat e tretë, por paraprakisht detyrohen që kuotat t'i afrojnë për blerje Ortakut tjetër dhe/ose Shoqërisë. Nëse Ortaku tjetër dhe/ose Shoqëria deklarohen negativisht për blerjen e kuotave ose nuk deklarohen aspak në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të ofertës, ortakët kanë të drejtë të transferojnë një pale të tretë sipas kushteve të ofruara Ortakut tjetër dhe/ose Shoqërisë.
- 10.5 Personi/subjekti që fiton kuotat është i detyruar të paraqesë në Shoqëri kërkesën për ndryshimin e kuotave, për t'u regjistruar në QKB.
- 10.6 Pronesia e kuotave evidentohet dhe regjistrohet në emër të ortakut ose ortakëve në Regjistrin e Aksioneve që mban Shoqëria.
- 10.7 Regjistri i kuotave do t'i përmbajë keto të dhëna për secilin Ortak: Emrin dhe Mbiemrin, numrin e identifikimit, numrin e pasaportës ose numrin e letërnjoftimit, datën, kur është bërë Ortak, vlerën e kuotave të cilën Ortaku ka paguar apo ka marrë persipër ta paguajë, kohën dhe mënyrën e pagesës, numrin e votave për procesin e vendimmarjes.
- 10.8 Administratori që mban Regjistrin e kuotave ka detyrim që Ortakut t'i leshojë Certificate pronësie të kuotave që Ortaku zotëron, të nënshkruar nga Administratori dhe të vulosur me vulën e Shoqërisë.
- 10.9 Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

10.10 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

10.11 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

10.12 Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

10.13 Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrijë shkaqet e largimit.

Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk e njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

10.14 Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku:

- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;

- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut;
- ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.
- 10.15 Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.
- 10.16 Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.
- 10.17 Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ai përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër. Nga çasti i regjistrimit të ndryshimit, sipas pikës 1 të këtij neni, shoqëria tregtare vijon si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm.

KAPITULLI IV **Asambleja e Përgjithshme**

Neni 11. Kompetencat

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare dhe ajo perbehet nga ortaku/ortakët e shoqërisë.
- 11.2 Asambleja është organi sovran i shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme thirret dhe me vendime të vlefshme sipas menyres së përcaktuar në dispozitat e ligjit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Asambleja e Përgjithshme përcakton dhe miraton të drejtat dhe detyrat e organeve të saj. Të zgjedhurit dhe të emëruarit nga Asambleja veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij statuti, aktit të themelimit si dhe ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Vendimet që merr Asambleja sipas këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi janë të detyrueshme për çdo ortak. Asambleja thirret të pakten njëherë në vit.
Secili ortak ka të drejtë vote sipas përqindjes në kuotën e kapitalit themelues të shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vlefshmërisht vendime me shumicë të zakonshme nëse janë të pranishëm ortakët të cilet përfaqësojnë më shumë se 30% të



votave. Në rastin kur ky kuorum nuk arrihet në thirrjen e parë, Asambleja e ortakëve do të thirret sërish me të njëjtin rend dite brenda dhe jo përtej 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga thirrja e parë; kuorumi mbetet i njëjtë.

- 11.3 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë një shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vlefshmërisht vendime, vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të votave janë të pranishëm. Në rastin kur ky kuorum nuk arrihet në thirrjen e parë, Asambleja e ortakëve do të thirret sërish me të njëjtin rend dite brenda dhe jo përtej 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga thirrja e parë; kuorumi mbetet i njëjtë.
- 11.4. Merren vlefshmërisht me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, vendimet që kanë si objekt çështjet në vijim:
- a. përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b. emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve dhe vendos për shpërblimin e tij/tyre;
 - c. emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe te audituesit e vendos për shpërblimin e tyre;
 - d. mbikqyrjen e zbatimit dhe të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
 - f. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g. përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë ndaj paleve të treta dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
 - h. miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i. miraton lidhjen e marreveshjeve për huatë, blerjen e pajisjeve për nevojat e veta, investimet vjetore.
 - j. miraton shit-bletjen e pasurive të paluajtshme;
 - k. Aprovon shit-bletjen e aseteve të Shoqërisë.
 - l. Vendos për marrjen ose dhenien e huave në emër të Shoqërisë, ose kredive.
 - m. Vendos për nënshkruesit e autorizuar të llogarive bankare të Shoqërisë.
 - n. Vendos për nënshkrimin e marreveshjeve midis Shoqërisë me Ortakun e saj ose Administratorin e Shoqërisë.
 - o. Aprovon nënshkrimin e marreveshjeve midis Shoqërisë dhe një shoqërie tjetër kur Ortaku u njeres shoqëri është Ortak ose Administrator në Shoqërinë tjetër.
 - p. Aprovon nënshkrimin e marreveshjeve të cilat e ngarkojnë Shoqërinë me detyrime afatgjata, me shume se një vit.
 - q. Jep autorizimin për Administratorin e Shoqërisë të nënshkruajë marreveshjet e Shoqërisë me palet të treta për vlera me të mëdha se sa i janë lejuar Administratorit.
 - r. Aprovon vendosjen mbi asetet e shoqërisë të pengjeve ose barreve hipotekore.
 - s. Aprovon strukturën organizative të Shoqërisë,
 - t. Aprovon Rregulloret administrative, procedurat operacionale dhe rregulloret që nevojiten



- u. Aprovon formatin e kontrates se punes, pagen per cdo kategori punonjesish.
 - v. miraton Vendime per ceshtje te tjera te parashikuara nga Statuti ose marreveshja per themelimin e Shoqerise te cilat nuk jane ne kompetence te Administratorit
- 11.5. Merren vlefshmërisht me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë **75% të ortakëve pjesëmarrës**, sipas kuorumit, vendimet që kanë si objekt çështjet në vijim:
- (i) ndryshimet e statutit;
 - (ii) rritja dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;
 - (iii) transformimi i Shoqërisë;
 - (iv) miratimi i projekteve të bashkimit dhe ndarjes;
 - (v) shpërndarja e fitimeve;

Neni 12. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme e thirrur rregullisht përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e saj, të marra konform ligjit dhe këtij statuti, përbejnë detyrim ligjor për të gjithë ortakët, edhe nëse mungojnë ose nuk janë të njëjtit mendim.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e percaktuar sipas ligjit ne fuqi. Ajo mund te thirret/mblidhet edhe jashtë selisë së Shoqërisë, por brenda territorit të Shqipërisë, me njoftim me letër rekomandë dhe/ose poste elektronike, dërguar ortakëve në vendbanimin që rezulton nga libri i ortakëve, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë.
- 12.3 Asambleja mund të thirret gjithashtu edhe nga eksperti kontabël i autorizuar, nëse ka të tillë, ose nga një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5 (pesë) për qind të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë.
- 12.4 Asambleja mund të thirret nga ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut. Ata mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin drejtepërsdrejti asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës dhe të kryejnë njoftimet perkatëse.

Nëse, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre

- 12.5 Në njoftimin e thirrjes se asamblese duhet të tregohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista/ rendi e/i çështjeve që do të trajtohen. Në mungesë të formaliteteve si më sipër asambleja konsiderohet e mbledhur rregullisht nëse në të perfaqesohet i gjithë kapitali themeltar dhe askush nuk kundërshton trajtimin e çështjeve të rendit të ditës. Asambleja drejtohet nga administratori.
- 12.6 Asambleja emëron një sekretar, edhe jo ortak dhe, nëse nevojitet, një ose disa vëzhgues, edhe jo ortakë. Kryetari i asamblesë konstaton mbledhjen e rregullt të saj, verifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmeve, drejton dhe garanton zhvillimin e rregullt të mbledhjes së asamblesë si dhe verifikon dhe shpall rezultatet e votimeve.
- 12.7 Mbledhjet e asamblesë mund të mbahen edhe me video-konferencë ose në telekonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe të dallohen në çdo moment të lidhjes, dhe t'u lejohet të ndjekin diskutimin, të marrin, transmetojnë dhe/ose vëzhgojnë dokumentet, të ndërhyjnë gojariht dhe në kohë reale mbi të gjitha çështjet, si dhe të marrin pjesë në votim dhe të bëjnë të mundur që vendimi të merret, në mënyrë të tillë që të mund të garantohet vendimarrja kolegjiale, zbatimi i parimeve të mirëbesimit dhe barazisë së trajtimit të ortakëve.
- 12.8 Në prani të kushteve të mësipërme, asambleja e përgjithshme konsiderohet e mbajtur rregullisht në vendin në të cilin gjendet drejtuesi i saj dhe ku duhet të ndodhet gjithashtu edhe sekretari, ku të mundësohet hartimi dhe nënshkrimi i procesverbalit në librin përkatës.
- 12.9 Çdo ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe të votës në asamble në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës që zotëron në kapitalin e Shoqërisë.
- 12.10 Ortakët mund të përfaqësohen në asamble nga persona të tjerë, edhe jo ortak, nëpërmjet një prokure të posaçme të lëshuar konform dispozitave ligjore në fuqi; rregullshmëria e prokurës do të verifikohet nga Kryetari i asamblesë. Administratori smund te perfaqesoj ortakët.
- 12.11 Prokura është e vlefshme vetëm për asamblenë përkatëse për të cilën lëshohet, e cila identifikohet në bazë të rendit të ditës. Ortaku nuk mund të japë prokurë për të votuar për një pjesë të kuotave së tij në kapitalin e Shoqërisë, nëse voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 12.12 Vota duhet të jetë e hapur ose gjithsesi e shprehur me modalitete të tilla që bëjnë të mundur identifikimin e ortakëve që nuk janë të të njëjtit mendim. Modalitetet e votimit miratohen nga asambleja, me propozim të Kryetarit, me shumicën e të pranishmëve.
- 12.13 Vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, të nënshkruar nga Kryetari dhe sekretari ose nga noteri, në rastet e parashikuara me ligj.



12.14 Vendimet e ortakëve do të mund të merren edhe nëpërmjet vendimit qarkullues me shkrim siç vijon.

Vendimet e propozuara, me iniciativën e një apo më shumë administratorëve apo të së paku një prej ortakëve, do t'i dërgohen të gjithë ortakëve, me cilindo mjet të shkruar, faks, telefax, poste elektronike apo postë të regjistruar.

Prej propozimit duhet të rezultojë qartë çështja objekt i vendimit qarkullues, arsyet dhe çka është e nevojshme për të siguruar një informacion të përshtatshëm mbi çështjen për t'u trajtuar, sikurse edhe teksti i saktë i vendimit për t'u marrë.

Secilit ortak do t'i kërkohet t'a dërgojë votën e tij me fax, poste elektronike apo telefax të konfirmuar me postë të regjistruar në dokumentin e dërguar, brenda afatit të treguar në propozim; mungesa e përgjigjes prej ortakëve brenda afatit të sipërpërmendur do të konsiderohet si votë kundër.

Vendimi do të konsiderohet i marrë kur :

(a) të gjithë ortakët kanë aprovuar paraprakisht diskutimin e çështjes objekt të vendimi qarkullues me shkrim dhe

(b) miratimet me shkrim te ortakëve të arrijnë kuorumin e kërkuar prej statutit.

Vendimi duhet të jetë i qartë dhe i pakushtëzuar dhe nga ai duhet të rezultojë nëse votimi ka qenë pro apo kundër vendimit të diskutuar.

Administratori/ët do të mbledhin vendimet e miratuara apo te refuzuara dhe do të njoftojnë ortakët mbi rezultatet e vendimit qarkullues me shkrim duke treguar ortakët që janë shprehur pro, ata që janë shprehur kundër dhe ata që kanë abstenuar, dhe vlerën e kapitalit të përfaqësuar nga secili prej tyre si dhe datën në të cilën është miratuar vendimi. Konsiderohet si datë e miratimit të vendimit data në të cilën mbaron afati i treguar në propozim.

Administratorët dhe/ose ortakët kanë të drejtë të kontrollojnë të gjithë dokumentet lidhur me çdo vendim qarkullues me shkrim.

KAPITULLI V Administratori

Neni 13. Administratori dhe kompetencat

13.1. Shoqëria drejtohet nga 1 (një) ose me shumë Administrator, të emeruar nga asambleja. Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë, dhe përfaqëson Shoqërinë para të



tretëve. Administratori mund të jetë i cdo kombësie dhe nuk është e nevojshme të jetë rezident në Shqipëri. Kompetencat e tij përcaktohen në bazë të Ligjit të Shoqërive dhe Statutit të Shoqërisë.

- 13.2. Kohëzgjatja e emërimit të Administratorëve është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, duke filluar që nga momenti që ky statut nënshkruhet, me të drejtë ripërtëritje të këtij mandati.
- 13.3 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë, me shumicë të zakonshme.
- 13.4. Asambleja e Përgjithshme përcakton numrin e administratorëve të Shoqërisë.
- 13.5 Administrator i parë i shoqërisë emërohet:

Z. Pavlo Mosko, shtetas shqiptar, lindur më Vlorë, 19.06.1955, banues ne Tiranë adresën: Rruga Frederik Shiroka, kulla 22 Hyrja 18, Ap. 24, Tiranë mbajtës i kartës së identitetit nr. F50619024I, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

Neni 14. Te drejtat dhe detyrimet

- 14.1 Administratori vepron në lidhje me cdo çështje të Shoqërisë që nuk është caktuar nën autoritetin e Ortakëve/ Asamblese se pergjithshme, në përputhje me këtë Statut, dhe cdo apo të gjithë vendimeve të Ortakëve si dhe ligjeve të zbatueshme.
- 14.2 Administratori duhet te marrë pelqimin e Asamblese per lidhjen e kontratave me persona të trete ne vlere me te larte se 1.000.000 leke ose 8.300 euro.
- 14.3 Administratori eshte personalisht pergjegjes ndaj Shoqerise dhe paleve te treta per demet e Shoqerise te shkaktuara prej tij nga veprimtaria ne kundersizim me ligjet e Republikes se Shqiperise, Marreveshjes per themelimin e Shoqerise, Vendimeve te Asamblese se pergjithshme dhe dokumenteve te tjera te Shoqerise.
- 14.4 Administratorit/ëve i jepen të gjitha kompetencat e përcaktuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë:
 - Administrimi dhe kryerja e operacioneve të shoqërisë në Shqipëri, si dhe kryerjen e çdo veprimi që mund të jetë i nevojshëm për drejtimin e veprimtarisë së Shoqërisë;
 - Organizimi i operacioneve të Shoqërisë dhe kryerjen e këtyre operacioneve;
 - Përfaqësimi i shoqërisë kundrejtë të gjitha subjekteve publike dhe/ose private, qoftë subjekte dhe/ose autoritete shqiptare apo të huaja;
 - Nënshkrimi, hartimin e çdo dokumenti, duke përfshirë edhe ato financiare, hapja dhe/ose mbyllja e llogarive bankarë në emër të Shoqërisë, në monedhë të huaj dhe shqiptare, si dhe nënshkrimin, hartimin e çdo dokumenti në lidhje me këto llogari bankare, kryerjen e

të gjitha veprimeve të ligjshme në këto llogari bankare, kryerjen e të gjitha veprimeve të ligjshme në këto llogari;

- Punësimin dhe shkarkimin e punëmarrësve në kuadër të politikave të përcaktuara nga Shoqëria;
- Realizimi i çdo veprimi tjetër të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm administrativ për administrimin e Shoqërisë;
- Nënshkrimi dhe dorëzimi i deklaratave tatimore dhe të deklaratave të tjera dhe raporteve pranë Regjistrisë Tregtare shqiptare dhe Zyrës së Tatimeve, si dhe pranë të gjitha organeve të tjera shtetërore të autorizuar dhe institucioneve ku kërkohet një dorëzim i tillë;
- Kryerjen e të gjitha akteve të tjera, veprimeve dhe çështjeve për administrimin efikas të Shoqërisë në Shqipëri.
- Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare
- Përveç sa është parashikuar në dispozitat e këtij statuti administratorët detyrohen:
 - a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi
 - b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthejnë ortakëve kontributet;
 - b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
 - ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes



financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) japin kredi

- Në rast se Shoqëria administrohet nga më shumë se një administrator, administratorët mund të ushtrojnë kompetencat e tyre veç e veç ose së bashku, siç përcaktohet nga Ortakët në vendimin e emërimit të tyre.

KAPITULLI VI

Administrimi financiar i Shoqërisë

Neni 15. Ekspertët Kontabël të Autorizuar

15.1. Ortakët duhet të emerojnë ekspertë kontabël të autorizuar në numrin dhe për kohëzgjatjen e përcaktuar nga ligji shqiptar.

15.2. Ekspertë kontabël të autorizuar kryejnë funksionet e kontrollit financiar në përputhje me ligjin Shqiptar.

KAPITULLI VII

Aktiviteti i Shoqërisë

Neni 16. Viti Financiar

16.1. Viti financiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti. Viti i parë financiar fillon në ditën e parë që është themeluar Shoqëria.

Neni 17. Mbajtja e Llogarive

17.1. Shoqëria mban financat në lekë dhe mban bilancin dhe llogaritë në përputhje me ligjin në Shqipëri.

Neni 18. Fitimet

18.1. Fitimet që rezultojnë nga bilanci ushtrimor do të shpërndahen ndërmjet ortakëve, proporcionalisht me kuotat që ata kanë respektivisht në kapitalin e Shoqërisë, pasi të jenë zbritur nga kjo shumë (i) vlera e humbjeve të pësuar gjatë vitit ushtrimor paraardhës si dhe (ii) të gjitha shumat e tjera që Asambleja e Përgjithshme vendos të destinojë për fondet e rezervës.



Neni 19. Prishja e Shoqërisë

19.1 Shoqëria mund të prishet në rrethanat e mëposhtme:

- (i) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilin është themeluar;
- (ii) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- (iii) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- (iv) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- (v) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga Neni 3/1 të Ligjit Tregtar;
- (vi) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- (vii) me vendim të gjykatës;
- (viii) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- (ix) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- (x) për cdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e përgjithshme.

19.2. Administratori (et) regjistrojnë prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar ("**Ligji për regjistrimin e biznesit**"). Në rast se prishja e Shoqërisë behet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të Ligjit për regjistrimin e biznesit, ia dërgon vendimin QKB-së për regjistrim.

KAPITULLI VIII

Të ndryshme

Neni 20. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

20.1. Cdo mosmarrëveshje, kundërshti ose pretendim midis Shoqërisë dhe një ose më shumë Ortakëve, që rrjedh ose në lidhje me këtë statut ose shkeljen, përfundimin ose pavlefshmërinë e tij, duhet t'i referohet dhe përfundimisht të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 21. Tërheqja e Ortakëve



21.1. Tërheqja ose përjashtimi i një Ortaku si dhe pasojat e këtij veprimi do të rregullohen nga Nenet 101, 102 dhe 103 të Ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (“**Ligji për Shoqëritë Tregtare**”).

Neni 22. Ligji i zbatueshem

22.1. Ky Statut rregullohet nga dhe duhet të interpretohet sipas ligjeve shqiptare në momentin e nënshkrimit të tij.

22.2 Me ndryshimin e ligjeve të zbatueshme, Asambleja e Përgjithshme do të reflektojë ndryshimet e dispozitave urdhëruese në këtë Statut.

Neni 23. Ndryshimet

Ky statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet dhe të zëvendësohet me një statut të ri me vendim të ortakëve.

Neni 24 Dispozita e fundit

Ky Statut është redaktuar në 2 (dy) kopje në Shqip.

ORTAKU THEMELUES

Altin Ceni

